

Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_727_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-497-2013 dt. 23 janar 2013 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë N.T.SH.“RIMED”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishtë me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, Lokacioni Kuqishtë, komuna e Pejës, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishtë me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, Lokacioni Kuqishtë, komuna e Pejës, të datës 26.02.2015 të shoqërisë N.T.SH.“RIMED”, me adresë: Magjistralja Prishtinë – Ferizaj “Laplja Selo”, Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** kërkesa e shoqërisë N.T.SH.“RIMED”, dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishtë me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, Lokacioni Kuqishtë, komuna e Pejës.
- II.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III.** Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.



Arsyetim

- ZRRE me datë 26.02.2015 nga shoqëria N.T.SH.“RIMED” ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, HC Kuqishtë me kapacitet të instaluar prej 3.1 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, Lokacioni Kuqishtë, komuna e Pejës.
- Bordi i ZRRE-së me datë 23 janar 2013, shoqërisë N.T.SH.“RIMED”, i ka lëshuar Vendimin V-497-2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-497-2013 dt. 23 janar 2013 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, dhe i vendimit V-707-2015 i datës 20 shkurt 2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar deri më 23 korrik 2015, të shoqërisë, N.T.SH.“RIMED”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.


V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar